

Në bazë të nenit 123, 131 dhe 132 të Ligjit për Arsimin e Lartë (Gaz. Zyrtare e RM-së nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15, 30/16, 120/16 dhe 127/16), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës si dhe në mbështetje të nenit 144 të Statutit të Universitetit të Tetovës, shpallet

## **KONKURS**

Për zgjedhjen-rizgjedhjen e bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës

Shpallet Konkurs për zgjedhjen-rizgjedhjen e bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës:

### **FAKULTETI EKONOMIK**

1. Një asistent-doktorant për lëndët mësimore në fushën e ekonomisë.

#### **Kushtet për thirrjen asistent – doktorant:**

- Diplomë për kryerjen e arsimit të lartë dhe marrjen e gradës shkencore magjistër i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet, si dhe dëshmi për regjistrimin e studimeve të doktoratës;

- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;

- Biografi e shkurtër (CV);
- Ta dorëzojë punimin e magistraturës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

\*Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje të asistent-doktorantit, të parapara me nenin 125-a të Ligjit për Arsimin e Lartë.

\*Fletëparaqitjen bashkë me dokumentet e nevojshme, kandidati duhet t'i dorëzojë në afat prej 5 ditë pune, nga dita e shpalljes së Konkursit, në Rektoratin e Universitetit të Tetovës, në adresën: Rektorati i Universitetit të Tetovës, Rr. e Ilindenit, p.n. Tetovë.

**Tetovë, 07.02.2018**

**Universiteti i Tetovës**